



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1607/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Telekom i Kosovës Sh.a, me seli ne rr. “Dardania” p.n, ne Prishtinë, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, me seli ne rr.”Bedri Gjina” pn, ne Mitrovicë te cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Lirim Zeka, rr.” Fehmi Agani” nr.138/5 ne Prishtinë, me bazë juridike: përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2639/22 dt.31.10.2023, me datën 02.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Telekom i Kosovës Sh.a, me seli ne rr. “Dardania” p.n, Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës– Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2639/22 i datës 31.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles e Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2639/22 dt.31.10.2023, ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Mitrovicës - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, me seli ne rr.”Bedri Gjinaj” pn, ne Mitrovicë dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.402/2022 dt.02.12.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj me seli ne Mitrovicë, si dhe ka përfunduar ne tërësi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi, ne afat ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës procedurale, vërtetimit te gabuar të së drejtës faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e kreditorit, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe çështja të kthehet në shkallë te parë.

Përgjigje ne ankesën e kreditorit ka ushtruar debitori, me propozimin qe gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj ne tërësi ankesën e kreditorit si të pabazuar, aktvendimi i atakuar te vërtetohet dhe të obligohet kreditori që debitorit t,ia paguaj shpenzimet e procedurës.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Telekom i Kosovës Sh.a, me seli ne rr. "Dardania" p.n, Prishtinë, me datën 01.12.2022, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, me seli ne rr."Bedri Gjinaj" pn, ne Mitrovicë, ne bazë te dokumentit te besueshëm - Faturës nr.91031092656. Përbaruesi Privat Ilmi Miftaraj nga Mitrovica, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përbarimor P.nr.402/2022 dt.02.12.2022, ka lejuar përbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga fatura ti paguaj shumën prej 326.43 euro, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit te urdhrin, me kamatë 8% duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e përbarimit.

Kundër urdhrin përbarimor debitori ka paraqitur prapësim me arsyetimin se fatura mbi bazën e te cilës është lejuar përbarimi nuk ka tipare te përbarueshmërisë, e njëjta nuk është nënshkruar e as vulosur nga debitori, ashtu qe kjo faturë sipas dispozitave procedurale dhe materiale nuk është e përshtatshme për përbarim, pra nuk është konform nenit 27 te LPP e as UA nr.15/2010-neni 20 par.1.1.17. Debitori ne këtë rast i referohet dhe Aktvendimit te Gjykatës Supreme te Kosovës CML.nr.24/2017 dt.17.01.2018 lidhur me përshtatshmërinë e faturave për përbarim te cilat sipas këtij aktvendimi duhet te jenë te nënshkruara dhe te vulosura, propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhri përbarimor te anulohet dhe te obligohet pala kreditore ti paguaj shpenzimet për prapësim.

Përgjigje ne prapësim ka paraqitur kreditori, me arsyetimin se e konteston prapësimin e debitorit, se debitori ka shfrytëzuar numrin ... duke krijuar borxhin e kërkuar ne vlerën prej 326.43 euro. Prapësimi është i mangët dhe ne kundërshtim me nenin 72 par.2 te LPP, debitori e ka pranuar faturën çdo muaj ne e-mailin ...@rks-gov.net dhe se kreditori ka komunikuar ne vazhdimësi me zyrtarët përgjegjës te debitorit, andaj propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitori si të palejuar dhe të pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2639/2022 dt.31.10.2023, me të cilin e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, ka anuluar urdhrin përbarimor ndërsa ka përfunduar procedurën përbarimore ne këtë çështje. Gjykata arsyeton se pas shqyrtimit te pretendimeve te debitorit, kreditorit dhe shkresave te lendes, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, arsyeton se nga fatura lëndore mungon objekti i detyrimit, fatura është lëshuar për periudhën prej 01.03.2022 deri me 31.03.2022 ndërsa ne të figuron që borxhi për këtë periudhë

është 00.00 euro si dhe borxhi paraprak është ne lartësi prej 326.43 euro, pra shuma totale e faturës përbehet nga ngarkesa për periudhën kohore të cekur me lartësi si dhe borxhin paraprak, pa treguar si ka rrjedhur ose për cilën periudhë kohore është borxhi paraprak. Gjykata po ashtu gjen se në faturë mungon nënshkrimi dhe vula e debitorit. Ndërsa në shkresë të lëndës nuk ka prova se debitori ka pranuar në ndonjë formë faturën lëndore. Nga komunikimi i e-mailit mes palëve gjykata konstaton se kreditori i kishte dërguar debitorit faturën që ta paguaj se bashku me disa fatura tjera ndërsa debitori i ishte përgjigjur se këto fatura nuk figurojnë si të pranuar nga ai dhe si të tilla nuk mund të paguaj, nga ky komunikim gjykata nuk gjen se debitori e ka konfirmuar pranimin e faturës lëndore përmes e-mailit. Fatura nuk përmban objektin (shërbimin) për të cilin kreditori ia ka lëshuar debitorit dhe se shuma e faturës nuk është përcaktuar në mënyrë të saktë sepse ajo nuk përmban vetëm borxhin për periudhën kohore të faturuar por edhe një borxh tjetër paraprak, ashtu që nuk i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 29 par.3 të LPP. Meqë nuk ka prova se debitori ka pranuar faturën lëndore, mos saktësimi të detyrimit monetar në të, vjen deri te mungesa e tipareve të përmbanueshmërisë së dokumentit të besueshëm, dhe me këtë edhe në zbatim të nenit 71 par.1 nenpar.1.1 të LPP, andaj edhe gjykata marrë parasysh edhe nenin 73 par.3 lidhur me nenin 13 par.1 nenpar.1.2 të LPP ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të saj.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Mbi bazën e rrethanave dhe fakteve, e në vlerësim të çështjes konkrete, rezulton se fatura nr.91031092656 mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi nuk përmbush kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sepse kjo faturë nuk plotëson kushtet ligjore për tu konsideruar dokument i besueshëm dhe si e tillë nuk mund të ekzekutohet, pasi e njëjta është e panënshkruar apo e pavulosur nga debitori, element ky bazë që shpreh vërtetësinë e pranimit të një dokumenti ndërsa në lëndë nuk ka prova se debitori i ka konfirmuar kreditorit pranimin e kësaj fature në mënyrë që e njëjta të ekzekutohet. Përkitazi kësaj çështje edhe kjo gjykatë vlerëson nenin 29 par.3 të LPP-së i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar“*.

Lidhur me këtë çështje gjykata e shkallës së dytë vlerëson edhe nenin 43 par.4 të LPP si edhe nenin 12 par.2 të ligjit nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore duke pranuar kështu në tërësi përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa pretendimet ankimore të kreditorit i analizon por i vlerëson si jo relevante për një

vendosje ndryshe pasi te njëjtat janë të pabazuara ashtu qe i refuzoi si te tilla ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përbarimore konfom parimit te rigorozitetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e Organit Përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1607//23 me datë 02.04.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha